

Mesazh mirëseardhje

Mesazh mirëseardhje

Të nderuar studente/studentë

Me lejoni që në emër të stafit të Drejtorisë së Qytetit tonë të përbashkët t'ju uroj suksese në vitin e ri akademik 2010-2011. e dini ky qytet ka identitetin e vet të pakontestueshëm ,i cili mbart në vete histori, epokë, revolucion, kulturë, evoluim, progres, novacion, etj. Juve, brezat që kanë kaluar dhe ato që vijnë përbëni substratin e trurit të kombit tonë.

Duke marrë parasysh specifikën e këtij qyteti, të gjithë së bashku do t'i japim kuptim dhe jetë bashkëjetesës, pra forcimit të kohezionin e brendshëm. Ky kohezion forcohet mbi frymën e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë. Jam thellë i bindur se edhe në këtë vit akademik do të vazhdojë tradita e investimit tonë të përbashkët për të forcuar standardet me qëllim që t'i japim qytetit "Studenti" dimensione evropiane.

Duke shfrytëzuar rastin, mesazhi im në thelb është i thjeshtë, por kuptimplotë. Ne, si staf menaxhues kemi bërë të gjitha përgaditjet për të krijuar ambjent sa më bashkëkohor. Edhe këtë vit akademik, jemi të përkushtuar maksimalisht për të përmbushur detyrimet ndaj jush. Në vijë të këtyre detyrimeve, prioritetet tona edhe për këtë vit akademik janë: salla studimi të pajisura me internet, siguri, qetësi, garanci për shërbimet publike, shërbim mjeksor, energji, uji, ambjent të pastër, stimuj për aktivitete kulturore, motivim dhe mbështetje për të ngritur iniciativa në funksion të përmirësimit cilësor të standardeve, komunikimi i ndërsjelltë, debate konstruktive, etj. Në këtë kontekst, le ta shndërrojmë këtë vit akademik si model te funksionimit të demokracisë konsensuale në vendimarrje.

Ju siguroj se juve studente e studentw të nderuar do të jeni faktorë vendimmarres për funksionimin cilësor dhe bashkëkohor të Qytetit "Studenti".

Ne e kemi gjithmonë derën e hapur për ju.

Mirë se erdhët !

Me respekt,
Bujar Brovina
Drejtori i Qytetit "Studenti" Nr.1